

V E N D I M
Nr. 524, datë 9.11.1999

**PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË REPUBLIKËN E ITALISË (MILANO)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I :

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë (Milano).

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave të parashikojnë në buxhetin e shtetit për vitin 2000, shpenzimet përkatëse për hapjen e kësaj zyre.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta